

VENDIM
Nr.345, datë 6.6.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.832, DATË 11.12.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ADMINISTRIMIT TË QYTETIT-MUZE TË GJIROKASTRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.832, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Për miratimin e rregullores së administrimit të Qytetit – muze të Gjirokastrës, shpallur nga UNESCO-ja “Pasuri e Trashëgimisë Botërore”.”.
2. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
A) Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit – muze të Gjirokastrës

1. Për administrimin dhe menaxhimin e Qytetit-muze të Gjirokastrës krijohet, në këtë qytet, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit-muze (më tej ZAKGJ), si person juridik publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Struktura dhe organika e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Qytetit-muze të Gjirokastrës miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Drejtori i ZAKGJ-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.
4. Marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrimet, si dhe procedurat e rekrutimit të punonjësve të ZAKGJ-së mbështeten në Kodin e Punës dhe në dispozitat e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.
5. Veprimtaria e ZAKGJ-së mbështetet në dispozitat e ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, në këtë vendim, aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi, si dhe në rekomandimet e UNESCO-s.
6. Rregullorja e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e specialistëve të ZAKGJ-së miratohen me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

- B) Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

ZAKGJ-ja bashkëpunon me organet e pushtetit, qendror dhe vendor, si dhe me UNESCO-n e organizatat e tjera ndërkombëtare etj., në bazë të marrëveshjeve të lidhura dhe në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare prej datës 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

